



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

AD/GJKK.nr.03/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Autoriteti Kompetent - Kryetari i Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga “Dukagjini” sh.p.k, me seli në Pejë, Rr. “Ismail Qemajli”, nr.2, me pronar E.Ll., ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë - F.B., bazuar në dispozitën e nenit 9 paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 10.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga “Dukagjini” sh.p.k, me seli në Pejë, me pronar E.Ll., ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, F.B., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate, nga E.Ll. - në cilësinë e pronarit në “Dukagjini” sh.p.k, me seli në Pejë, më 03.12.2024 ka pranuar ankesë për

inicimin e procedurës disiplinore kundër gjyqtarit së Dhomave të Shkallës së Dytë - F.B., me pretendimin për ekzistimin e një konflikti të drejtpërdrejtë të interesit.

Parashtruesi i ankesës në cilësi të pronarit të debitorit, në ankesën për inicim të procedurës disiplinore ka theksuar se lidhur me dyshimin e bazuar për ekzistencën e një konflikti të drejtpërdrejtë të interesit paraqesim faktin se në vitin 2010 gjyqtari z. B. ka shërbyer si administrator i përkohshëm i Kompanisë K.S “Dardania”, e cila ka qenë në pronësi të z. R.Ll. (vëllai i z. E.Ll.), ku pas vdekjes së tij kompania ka kaluar në pronësi të z. E.Ll., palës debitore në këtë rast, ku në rolin e tij si administrator i përkohshëm gjyqtari F.B. ka pasur kompetenca të plota për të ndërhyrë në menaxhimin dhe strategjitë financiare të kompanisë, duke krijuar kështu një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të ndjeshme me palën debitore (Dukagjini sh.p.k dhe me pronarin E.Ll.) në këtë çështje. Tutje ka theksuar se kjo situatë ngre dyshime të bazuara për interesa dhe përfitime personale, pasi që marrëdhënia e krijuar mes gjyqtarit dhe kompanisë dhe personalisht edhe me z. E.Ll. në atë periudhë mund të ketë ndikuar në paanshmërinë dhe objektivitetin e tij gjatë ushtrimit të çështjes aktuale. Ngase këto rrethana të kombinuara me faktin se gjyqtari nuk ka raportuar apo shmangur këtë konflikt të mundshëm interesi, ngrenë shqetësime serioze mbi integritetin dhe zbatimin e standardeve të pavarësisë gjyqësore siç parashikohet me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi. Po ashtu, ka theksuar se edhe motra e gjyqtarit në fjalë, znj L.B. gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë e punësuar në shoqërinë “Dukagjini” sh.p.k, rrethanë kjo e konfirmuar nga dokumentet e bashkangjitura si listat e pagave, e cila përforcon jo vetëm dyshimin mbi paanshmërinë e gjyqtarit në trajtimin e kësaj çështje, por edhe ngre shqetësime serioze për afërsinë personale dhe interesat e tij financiare të mundshme të lidhura me palën debitore në lëndën K.Dh.SHK.II.nr.800/24 ku ka vendosur gjyqtari F.B., sepse, punësimi i një anëtari të afërt të familjes në kompaninë e palës në procedurë ku vendos gjyqtari, krijon lidhje që mund të ndikojë direkt në objektivitetin e tij. Prandaj, kombinimi i këtyre rrethanave si lidhjet personale dhe familjare të ngushta, si dhe afërsia me interesat financiare të palës debitorë për të cilën gjyqtari ka vendosur, thekson rëndësinë e trajtimit dhe verifikimit të këtij rasti si një shkelje serioze e dispozitave ligjore dhe etike që garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësore. Sepse në rastin konkret gjyqtari z. B., me tu caktuar çështja K.Dh.SHK.II.nr.800/24, ku palë në procedurë është “Dukagjini” sh.p.k, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit dhe nuk është tërhequr nga shqyrtimi i çështjes, duke mos informuar udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë siç përcakton dispozita ligjore e nenit 5 paragrafi 1.2, 1.3 dhe

2.1 e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarë dhe Prokurorëve, në lidhje me nenin 8 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se zyrtari ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërlidhen me këtë çështje, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin”*. Pra, moszbatimi i dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit ka cenuar rëndë të drejtën e ankuesit për një proces të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, ka theksuar se sipas dispozitës ligjore nga neni 6 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, konflikti i interesit ka ndikuar ose duket se ka ndikuar në kryerjen me paanshmëri të detyrave zyrtare nga gjyqtari, ndërsa sipas nenit 7 paragrafi 1 të të njëjtit Ligj, ne kemi detyrim ligjor për të informuar institucionin tuaj mbi këtë konflikt. Andaj, në kuptim të nenit 16 dhe 9 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, ka kërkuar që të ndërmerren veprime ligjore për verifikimin e konfliktit të interesit dhe të konstatohet ky rast si shkelje serioze e dispozitave ligjore, si dhe të garantohet drejtësia dhe paanshmëria e çështjes në fjalë dhe të sigurohet që ankuesi të ketë qasje të barabartë dhe transparente në të gjitha çështjet e ardhshme që përfshijnë “Dukagjini” sh.p.k, e që lidhen me gjyqtarin z. B., duke marrë parasysh faktin se “Dukagjini” sh.p.k ka edhe raste të tjera që janë në procedurë brenda kompetencës së Gjykatës Komerciale.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës, më datë 04.12.2024 bazuar me nenin 9 paragrafi 5 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057, ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me ankesën me shkrim për Përgjegjësi Disiplinore për gjyqtarin F.B..

Bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës më 04.12.2024, ka kërkuar nga gjyqtari F.B. deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore.

Më 05.12.2024, gjyqtari F.B. në deklaratën e tij të dhënë me shkrim, lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën për iniciimin e procedurës disiplinore, ka theksuar se: Konsideroj se pretendimet e debitorit në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore janë të pa bazuara dhe nuk janë të mbështetura ligjërisht, janë deklarative me qëllim denigrimin e pozitës së gjyqtarit, dhe me tendencë për të ndikuar në vendimmarrje. Tutje ka theksuar se sa i përket pretendimeve si në parashtrësën e datës 03.12.2024, se kemi konflikt interesi për shkak se unë si gjyqtar për një periudhë disa mujore, gjatë viteve 2009-2010 (nuk më kujtohet saktë periudha kohore, sepse ka kaluar një kohë e gjatë afro 15 vite) kam qenë në pozitën e administratorit të përkohshëm të kompanisë së sigurimeve “Dardania”, ju njoftoj se në këtë pozitë jam emëruar me vendimin e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Guvernatorit të BQK (gjatë kohës sa kam qenë në marrëdhënie të rregullt punë në BQK), e ku në kohën e emërimit aksionar kanë qenë krejt persona tjerë. Po ashtu, ka theksuar se gjatë periudhës së administrimit kam bërë menaxhimin administrativ të kompanisë nën mbikëqyrjen dhe raportimin e rregullt të organeve më të larta të BQK-së, ngase pozita e administratorit ka pas qëllim menaxhimin administrativ për periudhën si në vendimin e Bordit të BQK-së, pa asnjë qasje në kompetencat e aksionarëve apo në shitjen e kompanisë, dhe se kam pasur akses vetëm në dokumentacionin financiar të KS Dardania, për periudhën e administrimit. Gjithashtu, ka theksuar se këtë pozitë e kam ushtruar përkohësisht deri në shitjen e kompanisë, e ku vendi im i punës ka qenë pozita mbikëqyrësit të lartë të sigurimeve dhe pensioneve në BQK, dhe se nga pozita ime në BQK (mbikëqyrës i lartë i sigurimeve dhe pensioneve) të cilën e kam mbajtur për 5 vite, kam bërë inspektime në të gjitha kompanitë e sigurimeve, sikur se të gjithë inspektorët e tjerë të BQK-së dhe kam qenë i njoftuar me gjendjen e të gjitha kompanive të sigurimeve në mënyrë të njëjtë, pa asnjë dallim (sikur në këtë rast që pretendon debitori se kam qenë i njoftuar me gjendjen e kompanisë ku vëllai i tij ka qenë aksionar), derisa asnjëherë të vetme nuk kam pasur dijeni për gjendjen financiare të Korporatës Dukagjini, pasi që as nuk ka qenë nën mbikëqyrjen e BQK-së. Tutje ka theksuar se nga shikimi në vendimin K.Dh.Sh.II.nr.800/24, rezulton se dokumenti përmbarimor është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, me datë 13.10.2010, e ku sipas gjitha gjasave në atë kohë veç se ka qenë e përfunduar periudha e administrimit në KS Dardania, ku tani në kohën e përpilimit të kësaj deklaratë nuk më kujtohet me saktësi data e përfundimit të administrimit, mirëpo jam i bindur se ka qenë i përfunduar administrimi në KS Dardania. Që nga data 22.10.2010 kam dhënë dorëheqje nga pozita në BQK dhe jam emëruar gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe që nga ajo kohë kam gjykuar në

qindra raste ku palë ndërgjyqëse kanë qenë kompanitë e sigurimeve, e në dhjetëra e dhjetëra raste ku palë ndërgjyqëse ka qenë KS Dukagjini dhe asnjëherë të vetme nuk është kërkuar përjashtimi im nga vendosja për arsye “*të konfliktit të interesit*”. Andaj me të drejtë shtrohet pyetja se çfarë konflikt interesi mund të kem unë me kompanitë e sigurimeve, kur asnjëherë skam qenë në raport interesi me asnjërën prej tyre. Kurse sa i përket pretendimit tjetër se motra e ime ka punuar për dy vite në KS Dukagjini për periudhën 2017-2019, ka theksuar se e vërteta është më ndryshe, ngase motra ime në këtë kompani ka punuar vetëm 5 muaj (shtator 2017 – janar 2018) e ku me kërkesën dhe vullnetin e saj ka dhënë dorëheqje dhe ka kaluar në vend tjetër pune, pr që nga ajo kohë kanë kaluar pothuajse 7 vite. Ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesa e Dukagjini sh.p.k, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

Kryetari i Gjykatës Komerciale të Kosovës, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi ankesën/kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë, deklaratën e gjyqtarit dhe shkresat e lëndës, gjeti se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ***është e pa bazuar***.

“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkuar...” - neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent ka vlerësuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në fjalë, dhe ka ardhur në përfundim se pala ankuese nuk ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse për të mbështetur një pretendim të tillë. Pra, paditësi nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën do të kishte paraqitur ndonjë nga shkaqet e parapara në nenin 67 të LPK-së, për përjashtimin obligator apo fakultativ të gjyqtarit për të gjykuar në rastin konkret. Andaj, pretendimet e paraqitura nga ankuesi nuk përbejnë shkelje disiplinore të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: *“Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”*, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: *"Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit"*.

Rrjedhimisht, nuk mund të konstatohet se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore apo të ketë vendosur kundërligjshëm, dhe nuk mund të konkludohet se gjyqtari ka bërë shkelje gjatë trajtimit të rastit, andaj, ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7 paragrafi 3 të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

AD.GJKK.nr.03/2024, më datë 10.12.2024

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale